



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E POKLITIKAVE EKONOMIKE DHE EPROMOVIMIT TË BASHKISË

Nr. 7059 prot

Roskovec, më 22.08 2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. 50, datë 22.08.2025

PËR
MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE PËR BASHKINË
ROSKOVEC

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 22, pika 1 dhe pika 4 dhe nenin 54, gërma k; Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", neni 12; Vendimin nr.1, datë 13.01.2022 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për miratimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta", Ligjin 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor"; VKM nr. 507, datë 10.06.2015 "Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative të rëndësishme në mjedis që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor"; Ligjin Nr.10 431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"; Ligjin nr. 107 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"; si dhe urdhrin e Kryetares së Bashkisë nr.60, me nr.1732 prot, datë 04.03.2025:

Ju paraqesim për diskutim dhe miratim:

1. Planin Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve për Bashkinë Roskovec, sipas draftit bashkëngjitur.
2. Pas miratimit të këtij projekt vendimi ngarkohet për zbatim Ndërmarrja e Shërbimeve Publike – Drejtoria e Menaxhimit të Territorit – Sektori i Gjelbërimit dhe Kompostimit të Mbetjeve Bimore.

Konceptoi: *E. Kuqo*

Konfirmoi: *D. Hoxha*

Për Drejtorinë Juridike: *V. Zeqo*

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETAR
MAKSIM GOGA**



**KRYETARI
Majlinda Bufi**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E POKLITIKAVE EKONOMIKE DHE EPROMOVIMIT TË BASHKISË

Nr. 7094/1 prot.

Roskovec, më 22.08.2025

Lënda: Relacion shpjegues për projekt vendimin ” Për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve Bashkia Roskovec”.

KËSHILLIT TË BASHKISË

Roskovec

Të nderuar anëtar të Këshillit Bashkiak,

Bashkia Roskovec ka hartuar Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve me mbështetjen teknike dhe financiare të projektit të financuar nga qeveria gjermane dhe nga GIZ Shqipëri, në kuadër të fazës së II-të të projektit “Modernizimi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta në mënyrë të përshtatshme me klimën dhe riciklimin”, si dhe fazës së III-të të projektit “BE për ekonominë qarkulluese për zhvillim të qëndrueshëm urban”.

Deri më sot, Bashkia Roskovec nuk ka pasur një plan të miratuar për menaxhimin e mbetjeve. Si një detyrim ligjor, lindoi nevoja për hartimin e tij. Me urdhër të brendshëm u ngrit grupi i punës, i cili ka punuar në bashkëpunim me ekspertët e caktuar nga GIZ.

Plani është hartuar me pjesëmarrjen aktive të stafit teknik të bashkisë dhe me asistencë nga partnerë ndërkombëtarë. Ai parashikon skenarë të ndryshëm për organizimin dhe financimin e shërbimit, si dhe një plan veprimi konkret për periudhën afatmesme.

Është hartuar VSM-ja bazuar në Ligjin 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor ”; si një dokument i rëndësishëm i këtij plani. Në muajin maj 2025 ka përfunduar drafti i planit dhe VSM, i cili më pas ka kaluar në fazat e konsultimit publik bazuar në VKM nr. 219, datë 11.03.2015” Për rregullat e procedurat për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor ”;. Konkretisht, drafti është publikuar në faqen zyrtare të bashkisë duke respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh, dhe është zhvilluar konsultimi publik më datë **02.06.2025**, me pjesëmarrjen e ekzekutivit të bashkisë dhe Këshillit Bashkiak, përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve, përfaqësues të Bankers Petroleum LTD, ECodes Consultancy, GFA Consulting, kryetarë fshatrash, administratorë të njësive, qytetarë etj.

Me synimin për të garantuar një sistem të qëndrueshëm, efikas dhe të përballueshëm për menaxhimin e mbetjeve, në përputhje me parimet e ekonomisë qarkulluese dhe mbrojtjes së mjedisit, plani synon rritjen e riciklimit, uljen e mbetjeve përfundimtare dhe përmirësimin e infrastrukturës dhe organizimit të shërbimit.

Sipas legjislacionit në fuqi, ky plan do të fokusohet në rrymën e mbetjeve bashkiake (urbane) për të cilën Bashkia Roskovec është drejtpërdrejt apo pjesërisht përgjegjëse:

Sipas përbërjes dhe mënyrës së menaxhimit të mbetjeve, mbetjet bashkiake do të klasifikohen në:

- **Mbetje urbane** (mbetje shtëpiake, ushqime, bimë, të riciklueshme, të dekompozuar, etj.), dhe
- **Mbetje të veçanta urbane** (mbetje nga ndërtimet dhe prishjet, voluminoze, pajisje elektrike dhe mobiljesh, etj.) që prodhohen nga familjet apo njësitë tregtare;

Sipas burimit të gjenerimit mbetjet urbane (bashkiake) klasifikohen në dy rryma:

- Mbetjet e gjeneruara nga familjet (MF)
- Mbetjet e gjeneruara nga bizneset dhe industritë (MB), ku përbërja e mbetjeve nuk ndryshon nga karakteristikat e mbetjeve urbane

Ndërkohë, rryma të tjera të mbetjeve klasifikohen si mbetje masive (voluminoze), mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (inerte), mbetje nga kopshtet që prodhohen në familje dhe që quhen 'mbetje të veçanta' për të cilat njësia vendore duhet t'i ofrojë e vetme ose në bashkëpunim alternativa të përshtatshme për grumbullimin dhe transportin e tyre, megjithëse largimi i tyre është përgjegjësi direkte e prodhuesit.

Objektivat kryesore të planit përfshijnë:

- Rritjen e ndarjes në burim të mbetjeve (organike, riciklueshme, të pariciklueshme).
- Reduktimin e sasisë së mbetjeve që dërgohen për trajtim final.
- Përmirësimin e mbulimit të shërbimit në të gjitha Njësitë Administrative.
- Krijimin e skemave për ndarjen e mbetjeve dhe kompostimin.
- Hartimin e rregulloreve vendore për menaxhimin e mbetjeve dhe përcaktimin e tarifave të qëndrueshme për shërbimin.
- Angazhimin e komunitetit përmes fushatave të informimit dhe edukimit mjedisor.
- Përcaktimin e investimeve të nevojshme dhe sigurimin e fondeve shtesë përmes burimeve të jashtme (GIZ, BE, qeveria shqiptare).

Miratimi nga Këshilli Bashkiak i këtij dokumenti do të mundësojë jo vetëm zbatimin e standardeve kombëtare dhe europiane, por edhe përmirësimin konkret të cilësisë së jetës së qytetarëve të Bashkisë Roskovec.

Në përfundim, bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenin 22, pika 1 dhe pika 4 dhe nenin 54, gërma k; Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011

"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", neni 12; Vendimin nr.1, datë 13.01.2022 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për miratimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta", Ligjin 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor"; VKM nr. 507, datë 10.06.2015 "Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative të rëndësishme në mjedis që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor"; bazuar në Ligjin Nr.10 431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit": Ligjin nr. 107 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i kërkojmë Këshillit Bashkiak Roskovec:

- **Miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve për Bashkinë Roskovec, sipas draftit bashkëngjitur.**

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,

Konceptoi: *E.Kuqo*


Konfirmoi: *D.Hoxha*

Për Drejtorinë Juridike: *V.Zeqo*

S.Kuku

suq

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETAR
MAKSIM GOGA**



**KRYETARI
Majlinda Bufi**